



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

L I G J

**PËR
DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 10 304, DATË 15.7.2010, “PËR
SEKTORIN MINERAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 2 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 19, pas fjalës “nuk lejohet” shtohen fjalët “kryerja e veprimtarive minerare per lejet ekzistuese dhe”
2. Në pikën 23, pas fjalës “mineralit” shtohen fjalët “të thatë”.
3. Në pikën 32, pas fjalëve "Kadastra minerare" shtohen fjalët “krijohet nga heqja e sipërfaqes nga fondi pyjor e kullosor dhe” dhe pas fjalëve “zonat e lejuara minerare” shtohen fjalët “të cilat rregjistrohen pas heqjes nga fondi pyjor e kullosor.”
4. Në pikën 37, fjalët “çdo vit” hiqen.

Neni 2

Në nenin 3, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Shteti për efekt të zbatimit të këtij ligji përfaqësohet nga ministri përgjegjës për veprimtarinë minerare.”

Neni 3

Në nenin 5, pika 2, ndryshohet si më poshtë:

“2. Sipas nenit 8 të këtij ligji:

2.1 Lejet minerare në zonat minerare, të përcaktuara në programin vjetor minerar si zona konkurruese, u jepen subjekteve të interesuara, fituese të një konkurrimi publik,

2.2 Ndërsa në zonat minerare të përcaktuara në programin vjetor minerar, si zona të hapura, leja minerare i jepet subjektit të interesuar, që plotëson kushtet e lejimit, sipas parimit "I pari në kohë, i pari në të drejta".

Neni 4

Në nenin 8 bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Në pikën 4, pas fjalëve “ministria dhe” shtohen fjalët “pas këshillimit me ministritë përgjegjëse për mjedisin, pyjet, tokën bujqësore, trashëgiminë kulturore, turizmin e mbrojtjen dhe njësitë e qeverisjes vendore përkatëse,”
2. Në pikën 6, pas fjalës “ministri”, fjalët “pas këshillimit me ministritë përgjegjëse për mjedisin, pyjet, tokën bujqësore, trashëgiminë kulturore, turizmin e mbrojtjen dhe njësitë e qeverisjes vendore përkatëse” hiqen.

Neni 5

Në nenin 9 bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Në pikën 1, paragrafi i parë, pas fjalës “teknik” shtohet fjala “mjedisor”.
2. Në pikën 2/b fjalët “nuk i ka shndërruar në leje shfrytëzimi, edhe pse ka zbuluar rezerva minerare me interes publik” zëvendësohen me fjalët “ka realizuar punimet e investimit sipas projektit, ka zbuluar rezerva me interes ekonomik, ka dorëzuar raport gjeologjik, por nuk ka kërkuar për ta shndërruar në leje shfrytëzimi.”
3. Në paragrafin e fundit të pikës 3, fjalët “deri në një vit” zëvendësohen me fjalët “ai i përcaktuar në pikën 1, të nenit 14”

Neni 6

Në nenin 13 bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Në pikën 4/b, fjalët “së paku 90 për qind” zëvendësohen me “deri në 90 për qind”.
2. Në pikën 4/c, fjalët “fillimit të vitit të katërt të” zëvendësohen me “zgjatjes së”.

Neni 7

Në nenin 14 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 fjalët “Afati i vlefshmërisë mund të zgjatet 2 herë, me kërkesë të zotëruesit të lejes. Çdo zgjatje ka afat 1-vjeçar.” zëvendësohen me fjalët “Afati i vlefshmërisë mund të zgjatet 1 herë, me kërkesë të zotëruesit të lejes, për një periudhë 1-vjeçare.
2. Në pikën 4, fjalia “Në rast se nuk shpenzohet vlera e përcaktuar, atëherë pjesa e mbetur i kalon Buxhetit të Shtetit”, hiqet.

Neni 8

Në nenin 16, pika 2, ndryshohet si më poshtë:

Zgjatja e afatit miratohet, në rast se zotëruesi i lejes së shfrytëzimit i ka plotësuar më parë detyrimet financiare, ka kryer investimet e parashikuara në programin e punës, në përputhje me lejen e dhënë, paraqet një program pune shtesë, bindës për ministrin, për vazhdimin e mëtejshëm të veprimtarisë së shfrytëzimit, dhe kur vazhdimi i shfrytëzimit nuk bie ndesh projekte të tjera që kanë interes publik.

Neni 9

Në nenin 17, pika 1/d, fjalwt “procedurave të përcaktuara në këtë ligj” zëvendësohen me “pikës 1, të nenit 17/1, të këtij ligji”.

Neni 10

Në nenin 18 bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Në pikën 1/b, fjalët “3 muaj” zëvendësohen me “6 muaj kalendarik” dhe fjala “tremujorit përkatës” zëvendësohet me fjalët “gjashtëmujorit përkatës kalendarik”.
2. Në pikën 1/c, pas fjalës “vit”, shtohet fjala “kalendarik”.
3. Në pikën 1/ç, në fund shtohet paragrafi:
Për lejet e shfrytëzimit me tre kordinata, subjektet duhet të paraqesin planin vjetor të punës, të hartuar në përputhje dhe të harmonizuar në kohë me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në lejen e tij minerare, për çdo vit, jo më vonë se 30 ditë kalendarike përpara përfundimit të vitit kalendarik.
4. Pika 4, e nenit 18, shfuqizohet.

Neni 11

Në nenin 19, pika 4, ndryshon si më poshtë:

Leja e kërkim-zbulimit ka afat vlefshmërie 1 vit nga hyrja në fuqi e saj, me të drejtë shtyrje për një vit, me sipërfaqe jo më shumë se 50% të sipërfaqes fillestare. Për sipërfaqen e mbajtur për vitin e dytë subjekti duhet të paguaj 150 000 lekë/km²

Neni 12

Në nenin 20, pika 1/b, ndryshohet si më poshtë:

b. t'i paraqesë strukturës përgjegjëse në përfundim të afatit të vlefshmërisë së lejes, raportin gjeologjik tekniko – ekonomik, me një informacion të detajuar mbi punimet e kryera në zonën e lejuar, investimet e realizuara, rezultatet e provave të marra, sasinë e rezervave dhe materialin grafik ilustrues.

Neni 13

Në nenin 22, pika 3, ndryshohet si më poshtë:

Shfrytëzimi i karrierve për qëllime publike vendore ose kombëtare, sipas përcaktimeve të nenit 23 të këtij ligji, mund të bëhet nga subjekti i krijuar nga njësitë e qeverisjes vendore, në pronësi dhe në juridiksionin e së cilës ndodhet karriera ose subjektet pjesëmarrëse në realizimin e projektit, të cilat kanë fituar të drejtën e realizimit të projektit me rëndësi kombëtare, por vetëm pas pajisjes së saj me leje shfrytëzimi, sipas procedurave të këtij ligji.

Neni 14

Në nenin 23, në pikat 1, 3 dhe 5, fjalët “ose subjektit, i cili ka fituar të drejtën e realizimit të projektit me rëndësi kombëtare” zëvendësohen me fjalët “subjektet pjesëmarrëse në realizimin e projektit, të cilat kanë fituar të drejtën e realizimit të projektit me rëndësi kombëtare”.

Neni 15

Në nenin 24, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, fjalët “të përcaktuar, dhe” hiqen.
2. Në pikën 6, fjalët “është subjekt i një shtese” zëvendësohen me “me të drejtë shtyrje”.

Neni 16

Në nenin 25, bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Në pikën 1/b, fjalët “3 muaj” zëvendësohen me “6 muaj kalendarik” dhe fjala “tremujorit përkatës” zëvendësohet me fjalët “gjashtëmujorit përkatës kalendarik”.
2. Në pikën 1/c, pas fjalës “vit”, shtohet fjala “kalendarik”.
3. Pika d, ndryshohet si më poshtë:
 - d) të japë informacione dhe shpjegime 1 vit më parë, nëse kërkon të ndërpresë veprimtarinë e prodhimit në zonën e lejuar;
4. Pas pikës d, shtohen pikat dh, e, ë dhe f, me këtë përmbajtje:

dh) të njoftojë jo më pak se 90 ditë kalendarike më parë, nëse kërkon ta pezullojë përkohësisht veprimtarinë e shfrytëzimit në zonën e lejuar;

e) të njoftojë jo më pak se 30 ditë kalendarike më parë, nëse kërkon ta zvogëlojë më shumë se 20 për qind sasi në e prodhimit, të parashikuar në planin e miratuar të prodhimit, pjesë e lejes përkatëse;

ë) t'i raportojë strukturës përgjegjëse, në përfundim të afatit të së drejtës së shfrytëzimit, me një informacion të hollësishëm, siç përshkruhet në aktet nënligjore, të miratuara nga ministri, për investimet e realizuara gjatë shfrytëzimit, për punimet minerare të kryera në zonën e tij të lejuar, shoqëruar me vizatimet inxhinierike.

f) të ketë personel të kualifikuar teknik gjatë gjithë kohëzgjatjes së lejes së shfrytëzimit.

Njoftimi, sipas shkronjave "d", "dh" dhe "e" të pikës 1 të këtij neni, duhet të përmbajë një informacion të hollësishëm për arsyet e pushimit, pezullimit apo uljes së prodhimit.

Neni 17

Në nenin 27, në pikën 2/b, fjalët “3 muaj” zëvendësohen me “6 muaj kalendarike” dhe fjala “tremujorit përkatës” zëvendësohet me fjalët “gjashtëmujorit përkatës kalendarike”.

Neni 18

Në nenin 29, bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Në fund të pikës 1/ç shtohen fjalët “ose kanë bashkëpunim me një subjekt tjetër me përvojë në fushën minerare”.
2. Në pikën 3, fjalët “dhe "ë”” hiqen.

Neni 19

Në nenin 30, bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Në pikën 4, fjalët “,që përfshijnë shfrytëzimin” zëvendësohen me fjalët “minerare të kërkim zbulimit, kërkim – zbulim – shfrytëzimit apo të shfrytëzimit”
2. Në pikën 8, fjalët “,që përfshijnë shfrytëzimin” zëvendësohen me fjalët “e shfrytëzimit dhe kërkim – zbulim – shfrytëzimit”
3. Në pikën 9, fjalët “që përfshijnë kërkim-zbulimin,” hiqen.

Neni 20

Në nenin 31, bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Në pikën 2, fjalët “çdo vit” hiqen, fjalët “Kjo vlerë” zëvendësohen me fjalët “Vlera e saj llogaritet në 10 për qind të vlerës totale të investimit,” dhe fjalët “dhe vlera e investimit me afatet për lejet e shfrytëzimit” hiqen.
2. Në pikën 2, fjalët “20 ditëve” zëvendësohen me “30 ditëve”.

Neni 21

Në pikën 2, të nenit 40, pas fjalës “mineralit” shtohen fjalët “të thatë”.

Neni 22

Neni 41, “Transferimi i të drejtave minerare nga zotëruesi”, ndryshon si më poshtë:

1. Lejet minerare, të dhëna sipas procedurave konkurruese, janë të transferueshme vetëm pas një periudhe 5 vjeçare nga data e dhënies së lejes dhe transferohen vetëm pas miratimit paraprak të ministrit. Çdo transferim i kryer pa miratimin paraprak është i pavlefshëm. Lejet minerare për të cilat është përfunduar një marrëveshje lehtësuese, nuk janë të transferueshme.
2. Lejet e tjera minerare, të dhëna sipas procedurave të Ligjit nr. 7796, datë 17.2.1994 "Ligji mineralar i Shqipërisë" janë të transferueshme vetëm pas miratimit paraprak nga ministri. Çdo transferim i kryer pa miratimin paraprak është i pavlefshëm.
3. Miratimi apo refuzimi i ministrit, sipas pikës 1, dhe 2 të këtij neni, bëhet brenda një afati prej 60 ditësh kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës së transferimit nga zotëruesi i lejes minerare.
4. Kriteret dhe rregullat e transferimit përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.
5. Akti i transferimit depozitohet pranë strukturës përgjegjëse dhe transferimi regjistrohet në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, si ndryshime të titullit të lejes, duke e plotësuar me të dhënat e identifikimit të zotëruesit të ri. Data e transferimit është data e regjistrimit. Akti i transferimit depozitohet edhe në regjistrin mineralar.
6. Ndërtimet dhe instalimet e tjera, që mbështesin operacionet kryesore, vlerësohen veprimtari ndihmëse të pandashme të së drejtës minerare dhe transferohen bashkë me të.

Neni 23

Pika 2, e nenit 57, ndryshon si më poshtë:

“2. Për të drejtat minerare të fituara në bazë të ligjit nr. 7796, datë 17.2.1994 "Ligji mineralar i Shqipërisë", i ndryshuar, sipërfaqja e zonës së lejuar dhe afati i miratuar nuk ndryshojnë me hyrjen në fuqi të këtij ligji, deri në përfundim të afatit të miratuar.

Zotëruesi i lejes së shfrytëzimit të grupit të mineraleve metalore ka të drejtën e shtyrjes së afatit të vlefshmërisë dy here. Shtesa e parë me të drejtë shtyrje 10 vjet dhe shtesa e dytë me të drejtë

shtyrje 5 vjet, me kusht që kjo shtyrje të kërkohet çdo here të paktën 365 ditë kalendarike para përfundimit të afatit të vlefshmërisë

Zotëruesi i lejes së shfrytëzimit të grupit të mineraleve ndërtimore ka të drejtën e shtyrjes së afatit të vlefshmërisë tre herë. Shtesa e pare me te drejte shtyrje 10 vjet, shtesa e dyte me te drejte shtyrje 10 vjet dhe shtesa e tretë me te drejte shtyrje 5 vjet, me kusht që kjo shtyrje të kërkohet çdo here të paktën 180 ditë kalendarike para përfundimit të afatit të vlefshmërisë

Afati i aplikimit është prekluziv dhe, me kalimin e këtij afati, zotëruesi i lejes minerare humbet të drejtën e aplikimit për shtyrje të afatit të lejes së shfrytëzimit.

Në çdo rast të kërkesës për shtyrje të afatit të vlefshmërisë, zotëruesi i lejes së shfrytëzimit duhet të paraqesë për shqyrtim pranë strukturës përgjegjëse një plan të hollësishëm me afate për zhvillimin e veprimtarisë minerare, në bazë të kërkesave të legjislacionit minerar në fuqi. Ky plan përfshin tërësinë e dokumentacionit teknik, ekonomik, financiar, social, mjedisor, si dhe vlerën e investimit me afatet për lejet e shfrytëzimit, duke garantuar financimin për realizimin e tij.

Plani miratohet nga strukturat përgjegjëse jo më vonë se 30 ditë nga data e paraqitjes së tij. Në rast mosmiratimi, struktura përgjegjëse e njofton zotëruesin e lejes minerare për arsyet e këtij mosmiratimi. Përmbajtja e planit të punës dhe dokumentet e tjera të nevojshme që e shoqërojnë duhet të jetë në përputhje me aktet nënligjore të miratuara nga ministri”.

Neni 24

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 22 dhe nenit 23.

Neni 25

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.